

L I G J
Nr.9432, datë 13.10.2005

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8978, DATË 12.12.2002 “PËR TAKSËN VENDORE
PËR BIZNESIN E VOGËL”, I NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.9327, DATË 6.12.2004**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 e 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8978, datë 12.12.2002 “Për taksën vendore për biznesin e vogël”, i ndryshuar me ligjin nr.9327, datë 6.12.2004, bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Tabela 1, e përcaktuar në pikën 4 të nenit 5 të ligjit nr.8978, datë 12.12.2002 “Për taksën vjetore për biznesin e vogël”, zëvendësohet me tabelën 1 bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Diferencat që mund të krijohen nga veprimi i këtij ligji, krahasuar me planifikimin e vitit 2005 për buxhetin e pushtetit vendor, do të kompensohen nga Ministria e Financave nëpërmjet grantit.

Neni 3

Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë udhëzimet përkatëse për zbatimin e këtij ligji.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.4683, datë 1.11.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

Tabela 1

Nivelet treguese të taksave vendore për biznesin e vogël (në mijë lekë në vit)

Nr.	Tipi i biznesit	Kat.1		Kat.2		Kat.3	
		Ishte	Bëhet	Ishte	Bëhet	Ishte	Bëhet
A	Shitje me pakicë	60	30	20	10	15	7,5
B	Shitje me shumicë	60	30	20	10	15	7,5
C	Prodhim	35	17,5	15	7,5	10	5
Ç	Shërbime	20	10	10	5	10	5
D	Profesione të lira	45	22,5	30	15	15	7,5
DH	Ambulant	15	7,5	10	5	10	5
E	Transport						
I	Transport pasagjerësh	Ishte				Bëhet	
	Automjete deri me 5 vende	35				17,5	
	Automjete deri me 6-9 vende	70				35	
	Automjete me 10-25 vende	80				40	

	Automjete me 26-42 vende	90	45
	Automjete me mbi 42 vende	95	47,5
2	Transport mallrash		
	Automjete deri në 2 tonë	55	27,5
	Automjete 2-5 tonë	80	40
	Automjete 5-10 tonë	95	47,5
	Automjete 10-16 tonë	100	50
	Automjete mbi 16 tonë	150	75
3	Transport ujqor		
	Transport detar, brenda vendit	110	55
	Transport në liqene, brenda vendit	95	47,5
	Varka për shëtitje	30	15

Kat.1: Bashkitë: Tiranë e Durrës;

Kat.2: Bashkitë: Shkodër, Korçë, Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë, Elbasan, Fier, Lushnjë, Pogradec, Berat, Lezhë, Kavajë;

Kat.3: Të gjitha bashkitë e tjera.

Në komuna, niveli tregues i taksës është 50 për qind e nivelit të tij tregues për çdo kategori.